

VENDIM
Nr.841, datë 6.12.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË
SHARRËS, FAZA III, NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Sharrës, faza III, në Bashkinë e Tiranës.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 4 107 (katër mijë e njëqind e shtatë) m² tokë truall, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen është 9 721 269 (nëntë milionë e shtatëqind e njëzet e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale do të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 4 107 (katër mijë e njëqind e shtatë) m² tokë truall, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha